



A BRIDGE TO SMART TOURISM
FROM LEZHA TO GJAKOVA

Traditë, Kulturë, Natyrë & Mikpritje



**Bashkojmë Urat e Turizmit midis
Lezhës dhe Gjakovës nëpërmjet
Trashëgimisë Kulturore**

Funded by



Funded by
the European Union



Albania - Kosovo
IPA Cross Border Cooperation Programme

Implemented by



BASHKIA LEZHË



KOMUNA E GJAKOVËS



creative business solutions

Lezha dhe Gjakova përbëjnë një itinerar të pasur kulturor, historik dhe natyror që bashkon dy qytete me tradita të thella shqiptare, mikpritje të ngrohtë dhe identitet të fuqishëm rajonal. Ky produkt i përbashkët ndërkufitar synon të promovojë një përvojë unike për vizitorët, duke ofruar histori, gastronomi, artizanat, agroturizëm dhe peizazhe mahnitëse.

LEZHA – UDHETIM NE HISTORI DHE KULTURE

Lezha ka ekzistuar që në kohët e hershme si vendbanim ilir. Muret e fazes me të hershme ndërtimore i perkasin shek VI p.k.

Qyteti ka patur dy porte: Nimpheum (Shengjin) dhe Oldrin mbui lumin Drin. Në vitin 48 para erës sone, gjate luftes midis Pompeut dhe Mark Antonit flota e ketij te fundit zbarkoi ne Shengjin. Ndersa kalaja e Lezhës u ndertua ne shekullin e VIII mbu themelet e Akropolisit te vjeter.

Sot Lezha, pervec historise se saj te lashte, perfaqeson nje destinacion terheqes turistik që kombinon detin, malin, kulturën dhe gastronominë tradicionale.

Kalaja e Lezhës ngrihet në lindje të qytetit në majë të një kodre që dominon mbi luginën e Drinit dhe ultesirën bregdetare. Ajo ka origjinë ilire dhe dokumentohet se ishte në listën e rindërtimeve të Perandorit Justiniani I Madh në shekullin e VI. Në vitin 1440 Kalaja iu nënshtrua një rindërtimi të ri nga venedikasin dhe në vitin 1522 u pasua nga një rindërtim tjetër pas pushtimit Osman. Në Kala mund të vërehen me lehtësi gjurmë të arkitekturave ilire, romake, bizantine dhe osmane. Në këtë Kala, objektet më interesante për tu vizituar janë rrënojat e ndërtesave osmane, xhamia, kulla në murin juglindor me një hark romak dhe kulla ilire në murin jugor.



Fig. 1 Pamje nga krahu jugor i kalase

Muzeumi arkeologjik është ndertuar ne vitin 2025 ne hyrje te zones se kalase. Aty jane vendosur artefakte te periudhave te ndryshme historike duke filluar nga antikiteti I hershem e deri ne mesjete perfshire amfora, maja heshtash, gure te punuar me mbishkrime dhe vlera te tjera qe deshmojne per nivelin e zhvillimit te territorit ne epoka te ndryshme. Nder te tjera, muzeumi ofron informacion audio dhe video per objekte ose vende te tjera me interes qe shtrihen ne itinerarin Lezhe – Gjakove perfshire objekte historike, kulturore, peisazhe natyrore e deri ne biznese agro-turizmi ku vizitoret mund te shijojne natyren dhe gatimet tradicionale te zones.

Fig. 2 Bllok prej guri gelqeror me nje mbishkrim romak qe informon mbi praktikën administrative dhe ndërtimore romake në provincat ilire në kohën e Jul Çezarit




Fig. 3 Amfora te shek II p.e.s. – shek I e.s. qe janë përdorur për transportin detar të verës, vajit të ullirit dhe produkteve të tjera ushqimore.



Fig. 4 Maja heshtash. Nga e majta ne te djathte: Maje bronzi e Epokes te Bronzit te Vone (shek. XII –IX p.e.s>). Maje hekuri e Periudhes Arkaike-Klasike (shek. VII – V p.e.s.), Maje hekuri e Periudhes Helenistike (shek. IV-II p.e.s.)



Udhëtimi në historinë e Lezhës vazhdon në mesjetë me **Memorialin e Skënderbeut -Katedralja e Shën Nikollit** si një nga monumentet më të rëndësishme të identitetit shqiptar. Në këtë vend më 2 mars 1444 u themelua Besëlidhja e Lezhës, ngjarja themelore e bashkimit politik dhe ushtarak të Arbërit. Në Kuvendin e Lezhës u mbledhën principata shqiptare nga veriu në jug përfshirë Kastriotet, Arianitasit, Dukagjinasit, Balshajt, Muzakat, Topiat, Zahariat, Gropat, Spanet, Dushmanet dhe princi i Malit të Zi.

Ky bashkim përbente një shembull të vecantë të unitetit të principatave të vogla që nuk ishte arritur as në vende me të mëdha të Evropës duke përbërur me sukses për 25 vjet ushtritë me të mëdha otomane të drejtuara nga Sulltan Muradi II dhe Mehmeti II.




Fig. 5 Memoriali i Skenderbeut

Kisha e Shna Prendes, zyrtarisht e njohur Shën Premtes është një kishë në Balldren që ndodhet 5 km nga qyteti i Lezhës. Kjo kishë e stilit romaniko-gotik mendohet të jetë ndërtuar në shekullin e XII-XIII. Kisha pati një restaurim i cili mendohet që është i vitit 1462 sipas mbishkrimit të vendosur në anën e jashtme të apsidës.



Fig. 6 Kisha e Shën Premtes



Fig. 7 Afresku Darka e Fundit

LEZHA – MEDITIM, RELAKS DHE ZBAVITJE NE NATYRE

Zona e Lezhës shquhet për bukuritë natyrore ku në distanca relativisht të shkurtra mund të levizesh nga deti në mal, nga laguna në lume, nga fusha në kodër dhe të bashkë me natyrën të shijosh pushimin, gatimin tradicional dhe prodhimet e vendit që shërbehet me pasion neper feramat e agro-turizmit ose hotelet rurale.

Laguna e Kune-Vain Rezervati Natyror i Menaxhuar Kune-Vain është zona e parë e mbrojtur në Shqipëri qysh nga viti 1940. Ky kompleks natyror i formuar nga grykederdhja e lumit Drin është perbere nga disa laguna dhe përfshin habitate detare, lagunore, moçale, pyje dhe livadhe. Rezervati është njohur për vlerat e tij natyrore dhe biodiversitetin e pasur, duke përfshirë më shumë se 360 specie kafshësh, prej të cilave rreth 190 janë të listuara në Listën e Kuqe të specieve të Shqipërisë.

Vend ideal për shetitje, fotografi dhe pushim në natyrë. Vetëm pak km nga Lezha.



Fig. 8 Laguna Kune - Vain



Fig. 9 Flamengo në lagune

Rana e Hedhun është një atraksion i vecante turistik që shtrihet në rreze të malit të Rencit dhe 15 km nga Lezha. Ky monument natyror përfaqëson një dune rreth 600 m të gjatë dhe 50 m të lartë të krijuar nga veprimi i erës mbi bregdetin shkëmbor. Përveç frekuentimit të lartë të plazhit ranor dhe ujit të pastër, ky peisazh e ka kthyer atë në një ndër destinacionet më të fotografuara në veriperëndim të Shqipërisë.



Fig. 10 Rana e Hedhun




Fig.11 Bregdeti në zonën e Ranës së Hedhun

AGROTURIZMI DHE GASTRONOMIA E LEZHËS

Të jesh në Lezhë nuk mund të mbetesh vetëm me soditjen e vlerave historike, kulturore apo natyrore. Kenaqësia e plotë e vizitës në këtë zonë nuk mund të ndahet nga kuzhina e njohur për shijen mesdhetare dhe produktet e freskëta të zonës. Peshku i detit, djathërat artizanale, perimet organike dhe verërat e zonës janë pjesë e identitetit gastronomik të Lezhës. Hoteli i Gjuetisë në Ishull-Lezhë ka një histori të vecante përtej natyrës së hoteleve. Ky hotel është ndërtuar në 1936 nga italianët për promovimin e turizmit dhe njerezve të apasionuar pas gjuetisë. Aty ka dhe një ndërtesë që lidhet me emrin e Kontit Galeazzo Ciano që shërbeu si ministër i Jashtëm në Mbretërinë e Italisë (1936-1943). Në vitin 1940, zona ku u ndërtua hoteli u shpall rezervat gjuetie, duke u kthyer kështu në të parën zonë të mbrojtur në Shqipëri.



Fig. 12 Hoteli i Gjuetisë në ishull – Lezhë

Zona rurale e Lezhes po njih lindjen dhe zhvillimin e agro-turizmit dhe turizmit rural. Ushqimi tradicional po kthehet ne art nepermjet rritjes se cilesise se pergatitjes, sherbimit dhe vecanerisht diversifikimit te produkteve.



Fig. 13 Mrizi i Zanave (18 km nga Lezha)



Fig. 14 Trendafili Mistik (9.8 km nga Lezha)

Fig. 15 Hylli i Drites (13 km nga Lezha)



Fig. 16 Oazi (18 km nga Lezha)

PRODIMI DHE TESTIMI I VERES

Ne zonen e Lezhës ka disa kantina të prodhimit të verës cilesia e të ciles është në rritje por më të mëdhatë janë kantina Atdheu kantina Mrizi i Zanave dhe kantina Kallmeti në fshatin Kallmet. Në këtë zonë gjendet verë e prodhuar tërësisht nga rrushi Kallmet që është një varietet autokton shqiptar i kultivuar në zonën e tij të origjinës.



Fig. 17 antina Kallmeti (13 km nga Lezha)



Fig. 18 Kantina Atdheu (12 km nga Lezha)

ARTIZANATI NË LEZHË

Artizanati rural ka ruajtur traditën e thurjes, qilimave, punimeve prej druri dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore. Produktet të dizenuara dhe prodhuara nga njësi artizanale të zonës si Artistike Zadrime, Colors of Zadrime apo Vasili Ceramic Studio dallohen për thjeshtësinë dhe autenticitetin e tyre.

Që të kuptosh më gjere vlerat e artizanatit të zonës, nuk duhet të mungosh edhe një vizitë në muzeun etnografik të qytetit. Pas një mungese të gjatë, muzeu etnografik u rihap në 23 tetor 2019. Aty janë ekspozuar 315 objekte me një koleksion të gjerë që ndër të tjera përfshin veshje tradicionale nga treva të ndryshme etnografike si Zadrime, Mirdita, Kallmeti, Pllana dhe pjesa e qytetit të Lezhës.



Fig. 19 Punime artizanale shqiptare




Fig. 19 Punime artizanale shqiptare



GJAKOVA - ZEMRA E ARTIZANATIT, KULTURËS & FRYMËS SHQIPTARE

Gjakova është qendra e mjeshtërisë artizanale dhe një nga qytetet me traditat më të pasura kulturore dhe shpirtërore në Kosovë.

Historia e Gjakoves dhe rrethinave të saj i ka gjurmët që në kohët antike me zbulimet arkeologjike që kanë treguar praninë e vendbanimeve të hershme ilire por zhvillimi më i madh ndodhi gjatë periudhës osmane kur qyteti u shndrrua në një qendër të rëndësishme ekonomike dhe kulturore.

Vetë Gjakova u themelua si qytet në shekullin e XVI dhe u bë e njohur për pazarin e saj të madh si qendër e madhe tregëtare në Ballkan.

Zhvillimin urban të Gjakoves e përshkruan edhe udhëtari turk Dervish Mehmed Zillî që njihet edhe si Evliya Çelebi i cili kaloi në Gjakovë në vitin 1663. Sipas tij, në këtë periudhë Gjakova kishte ndër të tjera 2000 shtëpi, dy xhami monumentale, dhe 300 dyqane.

GJAKOVA – UDHETIM NË TRASHËGIMINË MESJETARE

Gjakova nuk mund të kuptohet pa Carshinë e Madhe që ndryshe e njohur edhe si Pazar i vjetër, është pazari më i vjetër në Kosovë. Ajo u dogj dhe shkatërrua gjatë luftës të 1999, por u rindërtua. Pazar i mbulon një sipërfaqe prej rreth 65,000 m² dhe përgjate tij janë vendosur rreth 500 dyqane.



Fig. 21 Carshia e Madhe



Fig. 22 Xhamia e Hadumit e ndertuar ne shekullin e XVI e mirënjohur për dekorimet artistike dhe rëndësinë shpirtërore.



Fig. 26 Kompleksi Hani i Haraqisë gjendet në afërsi të Xhamisë së Hadumit.

Ami Boue përmend në vitin 1835 hanin e bukur të Haraqisë dhe të Islam Agës në Gjakovë.

Ndersa Mueller më 1838, përmend hanin dhe karvansarajin e madh të Gjakovës, që strehonte deri në 100 mysafirë, tregtarë me kafshët e tyre. Sot hani shërben si objekt hotelier dhe për organizime të ndryshme



Fig. 24 Kisha e Shen Palit dhe Shen Pjetrit është ndertuar ne 1917. U shkatërrua teresisht ne luften e vitit 1999. Ne te njejtin vend u ndertua katedralja e re.



Fig. 25 Kulla e Sahatit e ndërtuar pas Xhamisë së Hadumit. Kjo kullë e shkatërruar gjatë luftërave Ballkanike është rindërtuar me vone.

Është ndërtuar kryesisht prej guri me zonë të vëzhgimit prej druri dhe me çati të mbuluara me plumb, kulla e sahatit është unike në llojin e vet.



Fig. 23 Ura e Tabakëve - Një urë ikonike me gjatësi 127 m dhe gjerësi 4.03 m e ndërtuar ne shekullin e XVII me gure te gdhendur mbi lumin Erenik.

BUKURITE NATYRORE

Si cdo pjese tjeter te trevave shqiptare, edhe Gjakova ka nje numer te larmishem peisazhes natyrore terheqese jo vetem per vecorite por edhe per vizitoret qe pelqejne sportet ne natyre.




Fig. 27 Shpella e Kusarit gjendet në një terren gjarpëror në Malet e Pashtrikut ne afersi te fshatit Kusan qe mendohet se është ndër vendbanimet më të hershme të zonës së Gjakovës.



Fig. 28 Parku i Shkugzës është zonë rekreative dhe peisazh i mbrojtur në pjesën jugore të qytetit të Gjakovës i shtrirë mes dy kodrave të ndara nga lumi i vogël Shlepica, në lartësi mbidetare prej 410-460 m.



Fig. 29 Kanioni i Drinit te Bardhe është relativisht i shkurtër rreth 900 m i dhe thellësi prej 45 metra. Në hyrje të kanionit është Ura e Fshajt, një urë e vjetër Osmane

ARTIZANATI NE GJAKOVË

Gjakova është e njohur për filigranin, punimet e drurit, tekstile tradicionale, bakërpunimin dhe veglat muzikore. Punimet artizanale e kanë fillesen qysh në krijimin e qytetit. Vizitori mund të sodisë këto punime përgjate dyqaneve në Carshinë e Vjetër. Nëse kërkon të lidhë historinë e djeshme të artizanatit me të sotmen, vizitori ka mundësinë që të shohë në muzeun Oda e Zejtareve që gjendet në Carshinë e Madhe.



Fig. 30 Veshje tradicionale e Rekës së Keqe e ripërpunuar në viti 2010



Fig. 31 Thika pune prej hekuri



Fig. 32 Stoli koke për nuse nga filigrani - 1960



Fig. 33 Mbajtëse e lirave për nuse - 1950



Fig. 34 Orë e vjetër muri e shekullit XIX




Fig. 35 Goblen muri - Qëndisje artizanale në kanavacë -1990



Fig. 36 Muzeumi i zejtarisë "Öda e Zejtareve"



Fig. 37 Muzeumi etnografik

AGROTURIZMI NË GJAKOVË

Gjakova shquhet për disa pjatë tipike të saj si flija, pitet, qebabi gjakovar, tava gjakovare me perime dhe mish, samuna me suxhukë apo embelsirat me sherbet. Ushqimi tradicional mund të shijohet si në qytet ashtu edhe në rrethinat rurale. Lodhja që vjen nga vizitat e vendeve historike apo ecjet dhe ngjitjet në natyrë do të largohet pas ushqimit të mirë me pjatat tradicionale dhe mikrpitjen gjakovare.



Ky dokument është përgatitur nga projekti "Bashkojmë urat e turizmit midis Lezhës dhe Gjakovës nëpërmjet trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjeve të zgjuara" mbështetur nga programi IPA 2014-2020 i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri - Kosovë.

